

SH.S.SH T



1122  
22.09.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

MINISTRI

Nr. 1706 / Prot  
11

Tiranë, më 01.09.2020

URDHËR

Nr. 266 /, Datë 01.09 2020  
11

“PËR

**MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NGA KOMISIONET E VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE INVALIDËVE TË PUNËS PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19 ”**

Mbështetur në nenin 116, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligjin nr. 10107 datë 30.03.2009, i ndryshuar “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 7 të ligjit nr. 57/2019 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri” si edhe Udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

**URDHËROJ:**

1. Komisionet Mjekësore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar të nivelit të parë dhe Epror, të cilat funksionojnë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimit Social Shtetëror, Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë i nivelit të parë dhe Epror si dhe Komisionet Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar të nivelit të parë dhe të dytë, që funksionojnë pranë Shërbimit Social Shtetëror, të cilat kanë qenë të pezulluara për shkak të epidemisë COVID-19, nisin funksionimin e tyre duke respektuar masat për parandalimin e përhapjes së infeksionit, sipas përcaktimeve në këtë urdhër.
2. Afatet e parashikuara sipas rregulloreve të Shërbimit Social Shtetëror dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore të mos aplikohen për periudhën e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë COVID-19.
3. Anëtarët e komisioneve pajisen me të gjitha mjetet mbrojtëse (maskë mbrojtëse për fytyrën, doreza për duart) dhe ruajnë distancën fizike 1.5-2 metër nga njëri-tjetri dhe nga personi që paraqitet për vlerësim, për rastet ku komisionet nuk do të kryejnë vlerësim vetëm në mosje dhe është e domosdoshme prezenca e qytetarit.
4. Dezinfektimi i duarve duke përdorur një produkt me bazë alkooli jo më pak se 60% dhe larja e shpeshtë e duarve me sapun dhe ujë të rrjedhshëm për jo më pak se 20 sekonda.

5. Pastrimi dhe dezinfektimi i të gjitha ambienteve të komisioneve do të kryhet rregullisht çdo ditë dhe pas çdo komisioni do të kryhet ajrosja e ambienteve, për jo më pak se 15 minuta, si edhe dezinfektimi i të gjitha sipërfaqeve, mjeteve të punës dhe dorezave të dyerve.
  6. Shmangien e kontakteve me prekje dhe dhënien e duarve, shmangien e prekjes së fytyrës, gojës, hundës dhe syve dhe përdorimit të përbashkët apo shkëmbimit të sendeve personale.
  7. Për personat që paraqiten për vlerësim realizohet matja e temperaturës nga personeli që është i pajisur me veshjen e përshtatshme sipas protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
  8. Në ambientet e pritjes jashtë zyrës së vlerësimit, respektohen rregullat e distancimit social gjatë kohës që personat presin për të kryer procedurën e vlerësimit, duke ruajtur distancën prej 1,5-2 m larg njëri-tjetrit, dhe merren masa për të evituar grumbullimet masive të tyre gjatë pritjes, duke përcaktuar datat dhe oraret e vlerësimit për çdo rast.
  9. Përpara hyrjes në institucion vendoset një shtrojë e lagur me klor / hipoklorit natriumi për të dezinfektuar këpucët dhe mjetet ndihmëse të personave që do të paraqiten në komision.
  10. Personat që paraqiten për vlerësim duhet të jenë të pajisur me mjetet mbrojtëse (maskë mbrojtëse për fytyrën, doreza për duart).
  11. Respektimi rigoroz i masave të distancimit social, rregullave të higjienës, masive parandaluese, etj, nuk duhet të shkaktojë mundësi për diskriminim të personave që paraqiten pranë komisioneve për vlerësim.
  12. Në ambientet e komisioneve vendosen postera ilustrues të afishuara, postera të larjes dhe dezinfektimit të duarve, si edhe afishohen rregullat e ndryshuara të cilat do të zbatohen për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.
  13. Mjekët e komisionit në çdo rast të dyshuar ndjekin protokollin e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Institutit të Shëndetit Publik.
  14. Anëtarët e komisioneve mjekësore janë të detyruar të mos bëhen pjesë e mbledhjes nëse nuk ndjehen mirë ose nëse kanë simptoma të ngjashme me ato të infektimit nga COVID-19 dhe njoftojnë drejtuesin e institucionit nëse janë apo kanë pasur kontakt të ngushtë me një person pozitiv me COVID-19.
  15. Urdhri nr. 226, datë 02.04.2020, shfuqizohet.
  16. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës të nivelit të parë dhe Epror.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

